

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Sikafloor®-305 W

VESHJE IZOLUESE MAT PUR ME 2 PËRBËRËS DHE ME NGJYRË, PJSË E SERISË PËR DYSHEME SIKAFloor® COMFORTFLOOR®

PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Sikafloor®-305 W është veshje izoluese mat me ngjyrë prej poliuretani me 2 përbërës, me bazë uji dhe me çlirime të ulëta VOC.

PËRDORIMET

Sikafloor®-305 W duhet të përdoret vetëm nga profesionistë me përvojë.

Veshje izoluese mat për serinë e dyshemeve Sika ComfortFloor®, për poliuretan të lëmuar Sikafloor® dhe për serinë epokside Sikafloor® Multidur.

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Me bazë uji
- Aromë shumë e lehtë
- Rezistencë e mirë ndaj rrezeve UV dhe zverdhjes
- Pastrohet lehtë

INFORMACIONE MBI MJEDISIN

Certifikata e çlirimeve VOC sipas kërkesave të AgBB dhe DIBt (AgBB - Komiteti për vlerësimin lidhur me shëndetin të produkteve për ndërtimin, DiBt - Instituti Gjerman për Teknologjinë e Ndërtimit), Raporti Eurofins Nr. 769855D

MIRATIME / STANDARDE

- Llaç i hollë rrëshire sintetike për dysheme sipas EN 13813:2002, Deklaratë Performance dhe mbart markën CE.
- Veshje për mbrojtjen e sipërfaqes së betonit sipas EN 1504-2:2004, Deklaratë Performance 020801040050000031041, certifikuar nga organi i kontrollit të prodhimit në fabrikë 0620 dhe mbart markën CE.
- Klasifikimi në zjarr sipas EN 13501-1, Raport testimi 08-198, 08-199 dhe CR-13- 167/1, Universiteti Ghent

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	PUR	
Ambalazhi	Përbërësi A	kovë 8,5 kg
	Përbërësi B	kovë 1,5 kg
	Përbërësit A+B	njësi 10 kg gati për përzjerje
Paraqitja / Ngjyra	Sikafloor®-305 W është mat pas tharjes përfundimtare. Disponohet në ngjyra të ndryshme.	
Jetëgjatësia	Përbërësi A	6 muaj nga data e prodhimit
	Përbërësi B	12 muaj nga data e prodhimit
Kushtet e magazinimit	Produkti duhet të ruhet në ambalazhin original, të pahapur dhe të padëmtuar, në kushte të thata dhe temperatura midis +5°C dhe +30°C.	

Dendësia	Përbërësi A	~1,33 kg/l	(DIN EN ISO 2811-1)
	Përbërësi B	~1,13 kg/l	
	Rrëshira e përzierë	~1,18 kg/l	
	Të gjitha vlerat e dendësisë në +23°C		
Shkëlqimi	Këndi	Vlera	(ISO 2813)
	85°	< 50	
	60°	< 10	

TË DHËNA TEKNIKE

Fortësia Shore D	~84	(7 ditë / +23 °C)	(DIN 53 505)
Rezistenca ndaj abrazionit	<1000 mg	(H22/1000/1000)	(ISO 868)
Rezistenca e ndërkapjes në tërheqje	>1,5 N/mm ² (dështim betoni)		(EN 13892-8)
Rezistenca kimike	Rezistencë ndaj shumë kimikateve. Kontaktoni me shërbimin teknik për më shumë informacione.		

INFORMACIONE MBI SISTEMIN

Sistemet	Ju lutemi referohuni tek skeda teknike e sistemit:		
	Sika Comfortfloor® PS-23	Veshje elastike poliuretani për dysheme, pa bashkime, e lëmuar, me ngjyrë të njëtrajtshme dhe me VOC të ulët	
	Sika Comfortfloor® PS-27	Veshje elastike poliuretani për dysheme, pa bashkime, e lëmuar, me ngjyrë të njëtrajtshme, me VOC të ulët dhe e fortë	
	Sika Comfortfloor® PS-63	Veshje elastike poliuretani për dysheme, pa bashkime, e lëmuar, me ngjyrë të njëtrajtshme, me VOC të ulët dhe me izolim akustik të zhurmave	
	Sika Comfortfloor® PS-65	Veshje elastike poliuretani për dysheme, pa bashkime, e lëmuar, me ngjyrë të njëtrajtshme, me VOC të ulët dhe fleksibël	
	Sikafloor® MultiFlex PS-32 UV	Veshje elastike poliuretani për dysheme me izolues, e lëmuar, me ngjyrë të njëtrajtshme dhe e fortë	

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Raporti i përzierjes	Përbërësi A : Përbërësi B = 85 : 15 (për peshë)
Konsumimi	~0,13–0,15 kg/m ² /shtresë Kjo vlerë është teorike dhe nuk përfshin asnjë material shtesë për shkak të porozitetit dhe profilit të sipërfaqes, ndryshimeve në nivel dhe firos, etj. Kur përdoret në kushte konsumimi të lartë, për shembull kur ka qarkullim të karrigeve me rrota të zyrave, këshillohet së tepërmi një shtresë e dyfishtë Sikafloor®-305 W. Kjo shtresë e dyfishtë shton rezistencën mekanike të sistemit dhe rezistencën e tij veçanërisht ndaj karrigeve me rrota të zyrave.
Temperatura e mjedisit	+10 °C min. / +30 °C max.
Lagështia relative e ajrit	75 % max. Gjatë tharjes lagështia nuk duhet të kalojë 75 %. Duhet të ketë ajrosje të mjaftueshme me ajër të freskët për të larguar lagështinë e tepërt nga produkti që është duke u tharë.

Pika e vesës

Kujdes kondensimin!

Nënshtrësia dhe dyshemeja e patharë duhet të jenë të paktën 3 °C mbi pikën e vesës për të reduktuar rrezikun e kondensimit ose çngjyrosjes mbi finiturën e dyshemesë.

Temperatura e nënshtrësës +10 °C min. / +30 °C max.

Koha e punueshmërisë

Temperatura	Koha
+10 °C	~80 minuta
+20 °C	~60 minuta
+30 °C	~30 minuta

Kujdes: Përfundimi i kohës së punueshmërisë nuk është i kuptueshëm.

Koha e maturimit

Përpara veshjes së Sikafloor®-305 W lini:

Temperatura e nënshtrësës	Minimum	Maximum
+10 °C	24 orë	4 ditë
+20 °C	16 orë	3 ditë
+30 °C	12 orë	2 ditë

Bazuar në lagështi relative max. 70 % dhe ajrosje të mirë. Kohët jepen me përafërsi dhe do të ndikohen nga kushtet e ndryshueshme të mjedisit, veçanërisht temperatura dhe lagështia relative.

Produkti i aplikuar gati për përdorim

Temperatura	Qarkullim këmbësorësh	Qarkullim i lehtë	Tharja e plotë
+10 °C	~30 orë	~48 orë	~6 ditë
+20 °C	~16 orë	~24 orë	~4 ditë
+30 °C	~12 orë	~18 orë	~3 ditë

Shënim: Kohët jepen me përafërsi dhe do të ndikohen nga kushtet e ndryshueshme të ambientit.

UDHËZIME APLIKIMI

CILËSIA E NËNSHTRESËS / PËRGATITJA

Sipërfaqja duhet të jetë e pastër, e thatë dhe pa kontaminues si pisllëqet, vaji, graso, veshje dhe trajtime sipërfaqesh, etj. Pluhuri, materialet e lira dhe të shkrifëta duhet të hiqen plotësisht nga të gjitha sipërfaqet përpara aplikimit të produktit, preferohet me fshesë thithëse. Rezistenca ndaj tërheqjes nuk duhet të jetë më e ulët se 1.5 N/mm². Në rast dyshimi kryeni më parë një testim.

PËRZIERJA

Përpara përzierjes, përzieni mekanikisht përbërësin A. Kur i gjithë përbërësi B është shtuar tek përbërësi A, përzieni vazhdimisht për 3 minuta derisa të përftohet një miks i njëtrajtshëm. Gjatë përzierjes së përbërësve A dhe B shtoni 5-7 % ujë të pastër. Për të siguruar përzierje të plotë hidhni materialet në një enë tjetër dhe përzieni sërish për të arritur një miks konsistent. Pas përzierjes lëreni materialin të pushojë për 10 minuta. Duhet të shmangët përzierja e tepërt për të pakësuar bllokimin e ajrit.

Veglat e përzierjes:

Sikafloor®-305 W duhet të përzihet plotësisht me mikser elektrik në shpejtësi të ulët (300 - 400 rpm) ose pajisje tjetër të përshtatshme.

APLIKIMI

Përpara aplikimit, konfirmoni përmbajtjen e lagështisë së nënshtrësës, lagështinë relative dhe pikën e vesës. Përhapni në mënyrë të njëtrajtshme Sikafloor®-305 W me rul najloni me fije të shkurtëra. Sikafloor®-305 W mund të aplikohet gjithashtu me pajisje spërkatjeje pa ajër. Mund të arrihet finiturë pa bashkime nëse ruhet një skaj "i lagësht" gjatë aplikimit.

MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Pastroni të gjitha veglat dhe pajisjen e aplikimit menjëherë pas përdorimit. Materiali i ngurtësuar dhe/ose tharë mund të hiqet vetëm mekanikisht.

DOKUMENTA SHITESË

Cilësia & përgatitja e nënshtrësës

Ju lutemi referohuni tek Sika Method Statement: "VLERËSIMI & PËRGATITJA E SIPËRFAQEVE PËR SISTEMET E DYSHEMEVE".

Udhëzime aplikimi

Ju lutemi referohuni tek Sika Method Statement: "PËRZIERJA & APLIKIMI I SISTEMEVE TË DYSHEMEVE".

Mirëmbajtja

Ju lutemi referohuni tek "Sikafloor® - REGJIMI I PASTRIMIT".

KUFIZIME

- Produkti i freskët i aplikuar Sikafloor®-305 W duhet të mbrohet nga lagështia, kondensimi dhe uji për të paktën 7 ditë (+20°C).
- Nënshtratat e pabarabarta si dhe gjithashtu papastërtitë nuk mund të vishen me veshje izoluese. Prandaj dhe nënshtrata bashkë me zonat pranë duhet të pastrohen plotësisht përpara aplikimit.
- Gjatë aplikimit mbi një sipërfaqe epokside dyshemeja duhet të smerilizohet, preferohet me një sfjungjer smerilizues të gjelbër 3M për të siguruar ndërkapje të duhur.
- Nëse kërkohet ngrohje, mos përdorni ngrohës që konsumojnë gaz, vajguri, vaj parafine apo karburante të tjerë, pasi këto çlirojnë sasi të mëdha avujsh CO₂ dhe H₂O, që mund të ndikojnë negativisht finiturën. Për ngrohje përdorni vetëm sisteme elektrike ventilimi ajri të ngrohtë.

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

UDHËZIMI 2004/41/CE - KUFIZIMI I EMETIMEVE TË LIDHJEVE ORGANIKE FLURORE

Sipas Udhëzimit të BE-së 2004/42, përmbajtja maksimale e lejuar e VOC (Kategori produkti IIA / j lloji wb) është 140 g/l (Kufizimi 2010) për produktin gati për përdorim. Përmbajtja maksimale e Sikafloor®-305 W është < 140 g/l VOC për produktin gati për përdorim.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtratat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla saqë asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park
Ndërtesa nr. 7, kati 4
Tiranë - Shqipëri
Tel.: +355 4 454 0070
alb.sika.com
Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit
Sikafloor®-305 W
Mars 2019, Botimi 03.01
020812060030000002

Sikafloor-305W-sq-AL-(03-2019)-3-1.pdf

BUILDING TRUST

